



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 2643  
Dt 13.12.2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", pas shqyrtimit të kërkesës nr. prot. 1565, të datës 28.08.2019 nga Sindikata e UMIB-it, lidhur me statusin e laborantëve, në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2019, mori:

**VENDIM**

1. Këshilli Drejtues shpallet jokompetent për të vendosur për kërkesën nr. prot. 1565, të datës 28.08.2019 nga Sindikata e UMIB-it, lidhur me statusin e laborantëve.
2. Statusi i marrëdhënies së punës për të punësuarit në Universitet është e rregulluar me legjislacionin në fuqi: neni 151 dhe 152 të Statutit të Universitetit, neni 26 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, si dhe katalogun e vendeve të punës të aprovuar nga komisioni i përbashkët MAP-MF për Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" dhe Ligjin Nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë.

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues, pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës, konstaton se bazuar në të gjitha aktet aktuale në fuqi, si të Universitetit apo të ministrive përkatëse, përcaktimi i statusit të marrëdhënies së punës për të punësuarit në Universitet është i rregulluar me legjislacionin në fuqi dhe Këshilli Drejtues nuk është kompetent për ta ndryshuar atë.

Vendimi i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Afrim Qelës- kryetar i Sindikatës së UMIB-it;



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Dr. sc. Ali Topalli